

Emri i Lëndës : Marrëdhënia e Lajmit, Pushtetit dhe të Vërtetës							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 513	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Ramadan Cipuri, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Që nga shekulli I 16-të studiues e filozofë të shumtë janë përpjekur të përcaktojnë marrëdhëniet midis pushteteve, shteteve e medias dhe ndikimin e tyre mbi larinë e kontrollin. Përgjatë viteve, me ndryshimin e kushteve politike, ekonomike e sociale kanë parë dritë një numër teorish që reken të shpjegojnë këto marrëdhie. E pavarësisht ndryshimeve e orientimeve: teza e përbashkët është ndërvlarja e raporteve midis informacionit, medias dhe së vërtetës nga sistemet politike si dhe nga faktorë të tjerë përcaktues e dominant të pushtetit politik siç janë faktorët ekonomikë apo ato social që diktojnë e imponojnë më pas sisteme të caktura mediatike, ndërmjet të cilave informacioni, komunikimi qarkullon here duke respektuar deontologjinë e informacionit mediatik – rezultante e së cilës është e vërteta -here duke iu nënshtruar censurës, here censure së veshur me autocensurë – rezultante e së cilës është manipulimi. Më shumë se të vërtetën pushtetet preferojnë propagandën për të fshehur të vërtetën. Sot mediat janë kthyer në industria të ngritur sipas nevoja vetë një tregu të hapur, ku informacione shitet si mall i formatuar për interesa të ndryshme të shtetit e pushtetit por edhe në mënyra të ndryshme, tekst, foto, video, info grafistative apo e levizëshme: gjithçka e transmetuar, ndërmjet mjeteve, të shumta që nga njëra anë lehtësojnë komunikimit por nga ana tjetër krijojnë, një qark imponues e lehtësisht të manipulueshëm .					
Objektivat		Analiza e sistemeve politike, teorive të pushteti -instrumentave, qëllimeve për të vënë nën kontroll -sistemet e medias të gjendura nën presionin e vazhdueshëm të pushtetit qëllimi i vetëm i të cilit është kontrolli i informacionit. Nga ana tjetër analiza mbi optikën e ngjarjeve konkrete, konflikteve, luftarave të përcjella nga media të ndryshme nderkombëtare do të mundësojnë krijimin e hapësirave teorike e praktike (mbi kazus konkretë) mbi të cilat do ngrihen debate që do synojnë zbrëthimin e analizën e instrumentave mediatikë të përdorura nga pushtetet për të përcjellë të vërtetën apo për ta manipuluar atë duke ngritur struktura apo duke perdorur instrumenta , ideologji e filozofi tejet komplekse e që përcaktojnë edhe raportet e Lajmit, Pushtetit e së Vertetës.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Pushteti dhe politika, media dhe pushtetet						
2	Teoritë e Strukturë së pushtetit / Llojet e pushtetit						
3	Pushteti dhe lufta / Teoria e konfliktit/Cesura dhe autocensura						
4	Pushteti / shteti / Propaganda						
5	Sistemet ndërkombëtare e krahasuese të medias dhe pushteti						
6	Teoritë e marrëdhënieve qeveri/shtet-media						
7	Kontrolli dhe pronësia e medias / Ekonomia, media dhe pushteti						
8	Provim Gjysmëfinal						

9	Mbulimi i konflikteve, ngjarjeve, kontrolli redaksional/ E vërteta e manipuluar
10	Gjeopolitika e informacionit/ Ndikimi i mjeteve të propagandes
11	Ndërkombëtarizimi i medias dhe liria e informacionit/ Media sociale dhe pushteti
12	Globalizmi dhe ekonomia e informacionit/ Dallimet ekonomike të sistemeve
13	Teknika, gjini, stile e formate të përdorura nga kanale televizive informative apo media të tjera. CNN/BBC/Foks News/NewYork Times/Reuters/AP/AFP
14	Dominimi kulturor e ideologjik/Informacioni i stereotipizuar
15	Lajmet e rreme (Fake news)
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	• Çipuri, Ramadan, Vetëcensura, Realitete të gazetarisë shqiptare; Papirus, Tiranë, 2016 • Fuga, Artan. Mediamorfozë dhe metakomunikim; Papirus, Tiranë, 2017 • “Mbi televizionin”, Pierre Burdieu, Revista Polis 8, UET • Kissinger, Henry. Diplomacia; Shtëpia botuese e Lidhjes së shkrimtarëve, Tiranë
Referenca të tjera	• Media and Power - The International Journal on Media Management www.mediajournal.org/ojs/index.php/jmm • « Monolog », Artan Fuga, Dudaj, 2011 • Aliçka, Ylljet. Ndërkombëtarët; Tirana Times; Tiranë
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Organizimi dhe analiza e strukturës së lidhjeve midis Medias, Pushtetit e së Vërtetës e ngritur si lidhje e qënësishme mbi të cilat ndërtohen strategji komunikimi, informimi të përcjella ndërmjet sistemeve të caktura mediatike
2	Qëllimi kryesor është të kuptuarit se raportet midis Informacionit, Pushtetit e së Vërtetës nuk janë raporte rastësore por skema , strategji e politika që dominohen nga qëllime të paracaktura gjeopolitike, ekonomike e sociale që veprojnë e ushtrojnë presion e pushtet në forma të ndryshme brënda sistemeve të ndryshme mediatike. Është pushteti që imponon edhe ngritjen e fuqizimin e Sistemeve ndërkombëtare të informacionit. E në këtë situatë roli i medias për të përcjellë të vertetën është mjaft i rëndësishëm.
3	Objektiv i lëndës është studimi i këtyre raporteve si një tërësi elementesh që ndihmojnë për të kuptuar rolin e informacionit dhe komunikimit, instrumentat e kërkimit të së vërtetës, si një tërësi informacionesh, analizash, refleksionesh, burimesh që në botën e globalizimit të informacionit e me lindjen e mediave të reja mund të sigurohen më lehtësisht se më parë. Ashtu si mund të manipulohen edhe më lehtë se më parë. Njohja e funksionimit të raporteve Media, Pushtet e Vërtetë...e afron më shumë të vërtetën duke na mbrojtur më shumë edhe nga manipulimi, thotë Christian Kakam, në librin e tij “Pushteti politik dhe manipulimi”.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	26	26
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00